

NE EMER TE POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN DEGA NË VITI, Departamenti i pergjithshem, divizioni civil si gjykatë e shkallës së parë, sipas gjyqtarit Nexhat Aliu me Sekretare Juridike Azize Rama, duke vendosur në qështjen kontestimore të paditësit Z. S. nga Vitia Rr" xxx" pa nr, kundër të paditurit S.A. (T) , nga Kllokoti, baza e kontestit vërtetim i pronsisë, e pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqsor, oral dhe publik, me datën 13.04.2017, shpallë këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kerkese padia e paditsit Z. S. nga Vitia Rr" AXXX." pa nr, i **njihet** e drejta e pronsise ne ngastrën katastrale nr. XXXX, në vendin e quajtur "MXXX" në sipërfaqe prej XXX m2, ZK.Kllokot ne emer të S. A. (T.), **ne baze te shitblerjes**.

OBLIGOHENT I padituri Sl. S. (A), qe tia pranojn paditësit te drejten e pronsise dhe te durojn qe ngastren kadastrale te regjistrohet ne emer te tij.

OBLIGOHET Sherbimi Katastral në Kllokot, që të bëjë ndryshimin në bazë të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi Z. S. ka deklaruar: mbetem në tërsi pran padisë dhe kërkes padis dhe kerkoj nga gjykata që të më njihet e drejta e pronsisë dhe atë në ngastrën katastrale nr.XXX shfrytzimi actual bujqësor arë e klasës 3 në sipërfaqe prej XXXXm2 , të parashkruar në qertifikatën e pronës nr.XXX ZK.Kllokot. Këtë ngastër paditësi deklaroi se e kam bler prej S. S. dikur para 10 viteve , ku të paditurit ja ka dhen të hollat në përgjithësi sipas qmimit të kontraktuar kam hyrë në posedim dhe shfrytëzim pa u penguar nga askush.Këtë ngaster e kam bler me valut Euro , e cila ngaster në shumë të përgjithshme ka kushtuar xxx Euro. Andaj kërkoj nga Gjykata që të më njihet e drejta e pronësis në këtë ngastër.

I padituri S. S. A. , djali I S. A. (T) deklaroi se nuk e kundërshtoj padien e as kërkes padien nga se është e vërtetë se paditësi Z. S. e ka bler këtë ngastër dhe e ka paguar në tërsi dhe ka hyrë në posedim dhe shfrytëzim pa u penguar nga askush.

Gjykata me dt...XXXXX, ka dalurë në vendin e ngjarjes në Kllokot në vendin e quajtur "M.."së bashku me ekspertë e gjedozisë ku ka bërë identifikimin e ngastres , të lartë permendur që paditësit ti njihet e drejta e pronsies.

Ne proceduren e provave gjykata ka lexuar Certifikaten me nr.xxx. e dt.xxxx, në emër të S.A.T...

Lexohet kopja e planit e dt.xxxx në emër të S.. A... T...

Lexohet qertifikata martesore nr..xxx e dt.xxx, nga e cila shifet se Sxxxx Sxxxx është djali I A.. S...

Lexohet ekspertiza nr....xxx, e dt.xxxx të përpiluar nga eksperti i gjeodezisë V..S..

Paditesi Z.. S.. në fjalën perfundimtare të palve ka deklaruar : mbetem në tërsi pran padisë dhe kërkes padisë dhe kërkoj nga gjykata që të më njihet e drejta e pronsisë në ngastren kadastrale nr.xxxx në sipërfaqe prej xxxm²,ZK.Klllokot, ku pas mbajtjes së disa seancave daljes se gjykates në vendin e ngjarjes së bashku me ekspertë të gjeodezisë, ekspertizës së ekspertit të gjeodezisë si dhe deklarates së dhënë të paditurit S.. S..A..., është vërtetuar mjaftë se në mes paditsit dhe të paditurit ka egzistuar një raport juridiko civil , i pa shkruar por me hyrje dhe mbajtjen e paditësit të kësaj ngastre para disa viteve , e qe prodhon efektë juridik. Andaj kërkoj nga Gjykata ta aprovon padin dhe kërkes padijen dhe të bejnë një aktgjykim meritor në base të ligjit.

Gjykata analizoi thenjën e pales ndergjygjse, provat e administruara dhe konstatoi se ngastra katastrale : nr.xxx, e evidentuar ne Certifikaten me nr.xxx, e dt.xxx, në emër të Sxx A.. (T..), këtë ngastër paditësi Z. S..kishte blerë nga i paditurit S..S.. A.. diku para dhjetë viteve, që vertetohet nga deklaratat e dhëna në seancë gjyqsore, të dates xxx nga I padituri S.. S.. A.. paditsi e kishte blerë këtë ngastr dhe kishte hyer në posedim dhe shfrytzim pa u penguar nga askush, ku dhe sotë paditësi e punon këtë ngastër pa u penge nga askush, nga keto arsye, i njihet e drejta e pronsisë, paditsit Z..S. nga Vitia , si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN -DEGA NE VITI

C.nr. 431/2013

Me.13.04.2017

Sek. Juridike:
Azize Rama

Gj y q t a r i
Nexhat Aliu

Kshilla juridike:kunder ketije aktgjykimi munde te ushtrohet ankese, ne afat prej 15 ditesh nga dita e marrjes, ne Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kesaj gjykate.